

LASGUSH PORADECI
Vdekja e nositit
(nga vëllimi “Vallja e yjeve”)

Me zjarr ju flas..., me zjarr.
Në gjirin t’im kam hapur varr...
Që t’i jap shpresë-edhe t’j-a mar...

Un’ ik liqerit zemërak
Fatlum dh’i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:

Se vijnë-urtuar zoqtë-e mi,
Dh’u jap ushqim me dashuri —
Një dashuri për llaftari:

Pa nis ah! gjirin t’a godas...
Dh’e hap ah! — gjirin më një ças...,
Dh’i nginj ah! zoqtë-e vdes me gas!...

Ahere-helmohet e buçet
Pas mallit t’im liqeri-i shkret.
E rit tallazin posi det.

Ay e tund, ay e shkund,
Ay e hap sa me të mund,
Gjer mun në gjit, gjer mun në fund,

E shpirtin dyke m’a përcjellë,
Më thotë ah! shih sesa ’sht ’i fellë
Ky gjir’ i em që të pat pjellë...

...Me zjarr ju flas, me zjarr.

